

AKTI I THEMELIMIT

I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“Retreats Albania” sh.p.k

Në mbështetje të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar dhe Ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, i ndryshuar, sot më datë **19.02.2025**, anëtarët e poshtëshënuar:

1. Znj. **Andrea Berner**, shtetase Gjermane, lindur më 19.12.1973 Stuttgart Gjermani, banues në Rr “Perlat Rexhepi” Kati 5 Ap. Nr. 52 Tiranë, Zip Kode 1019, mbajtëse e Pasaportes me Nr: C3FLYNXCK7D, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar.
2. Z. **Albert Kola**, shtetas shqiptar, lindur më 04.07.1984, në Fierzë, banues në Tiranë, mbajtës i Kartës së Identitetit me Nr. personal: I40704069G, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

kanë vendosur të nënshkruajnë Aktin e Themelimit të mëposhtëm, për krijimin e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, aktiviteti i së cilës rregullohet nga Legjislacioni shqiptar në fuqi dhe Statuti i saj.

NENI 1

EMËRTIMI I SHOQËRISË

- 1.1. Emërtimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është **“Retreats Albania” sh.p.k**, në vijim referuar si **“Shoqëria”**.

NENI 2

BAZA LIGJORE

- 2.1. *Shoqëria* do të ushtrojë veprimtarinë e saj në bazë të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar, Ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, i ndryshuar dhe legjislacionit shqiptar në fuqi.
- 2.2. Kjo *Shoqëri* fiton zotësinë për të vepruar me regjistrimin e saj në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

NENI 3

SELIA

- 3.1 Selia kryesore e aktivitetit të *Shoqërisë* është në adresën: Rruga “Gjon Krisili, Ndertesa 64”, Tiranë, Shqipëri.

NENI 4 OBJEKTI

4.1. Objekti kryesor i veprimtarisë së *Shoqërisë* përfshin sa më poshtë vijon:

Qëllimi i Retreats Albania Sh.p.k. është të ofrojë përvoja transformuese trajnimi sportiv që fuqizojnë individët e të gjitha moshave përmes Shaolin Kung Fu, që përfshihet Yoga, Qi Gong, Tai Chi, Fitnesi me ushtrimet e Kung Fu-së dhe Vetë-Mbrojtje. Ne fokusohemi në forcimin e trupit dhe mendjes, duke nxitur rritjen personale dhe krijimin e një lidhjeje të thellë me natyrën. Programet tona të trajnimit janë të dizajnuara për të frymëzuar dhe mbështetur individët në arritjen e mirëqenies, qëndrueshmërisë dhe balancës, përmes aktiviteteve të fokusuara në vende të ndryshme, si brenda Shqipërisë ashtu edhe jashtë saj.

Programet e Trajnimit Sportiv:

Ofron trajnime të specializuara përmes Shaolin Kung Fu, që përfshihet Yoga, Qi Gong, Meditim, Tai Chi, Fitnesi me ushtrimet e Kung Fu-së dhe Vetë-Mbrojtje.

Zhvillimi Fizik dhe Mendor:

Fokus në forcimin e trupit dhe mendjes, duke inkurajuar një qasje të ekuilibruar dhe të qëndrueshme ndaj jetës. Rritja Personale: Mbështet individët në zhvillimin e qëndrueshmërisë, mirëqenies dhe balancës, duke promovuar një mentalitet pozitiv dhe një lidhje të thellë me vetveten.

Trajnim në ambient natyror:

Realizimi i aktiviteteve në mjedise natyrore për të forcuar lidhjen me mjedisin në lokacione të ndryshme të Shqipërisë.

Programet Pjesëmarrëse:

I përshtaten individëve të të gjitha grupeve të moshës dhe niveleve të aftësisë.

Qasja e Orientuar nga Qëllimet:

Projektimi i programeve për të ndihmuar pjesëmarrësit të arrijnë qëllimet specifike të zhvillimit personal dhe fizik, duke promovuar një progres të qëndrueshëm dhe të matshëm.

Vendodhje të rëndësishme:

Ofrimi i trajnimeve në vendodhje dhe mjedise të ndryshme brenda Shqipërisë dhe ndërkombëtarisht.

Trajnim në Mbrojtje Personale:

Ofrimi i udhëzimeve në mbrojtje personale për të promovuar sigurinë dhe besimin.

Shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet ndihmës dhe të nevojshëm që është në përputhje me këtë objekt aktiviteti, duke mos kundërshtuar ligjet shqiptare në fuqi.

NENI 5 KOHËZGJATJA

- 5.1. Kohëzgjatja e aktivitetit të shoqërisë është me afat të pacaktuar.

NENI 6 KAPITALI THEMELTAR

- 6.1. Kapitali themeltar i Shoqërisë është 100.000 (njëqind mijë) Lekë, tërësisht i nënshkruar dhe i pashlyer nga Ortakët Themelues të shoqërisë përpara regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.
- 6.2. Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga 2 (dy) kuota, në raport me kontributin e dhënë nga çdo ortak në shoqëri.
- 6.3. Pjesët e kapitalit zotërohen nga ortakët si më poshtë:
- a) Ortaku Znj. Andrea Berner zotëron 55 % (pesëdhjetë e pesë përqind) të kapitalit të shoqërisë ose 1 (një) kuotë me vlerë të barabartë me 55.000 Lek (pesëdhjetë e pesë mijë).
 - b) Ortaku Z. **Albert Kola** zotëron 45 % (dyzetë e pesë përqind) të kapitalit të shoqërisë ose 1 (një) kuotë me vlerë të barabartë me 45.000 Lek (dyzetë e pesë mijë).

NENI 7 TRANSFERIMI I PJESËVE TË KAPITALIT THEMELTAR

- 7.1. Pjesët e kapitalit themeltar janë të transferueshme ndaj të tretëve sipas procedurave të parashikuara në Statutin e shoqërisë dhe në Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar.


NENI 8 ADMINISTRIMI

- 8.1. Emërohet Administrator i *Shoqërisë* Znj. **Andrea Berner**, shtetase Gjermane, lindur më 19.12.1973, në Stuttgart Gjermani, banuese në Tiranë, mbajtëse i pasaportes me Nr: C3FLYNXCK7D, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar.
- 8.2. Administratori do të ushtrojë të gjitha kompetencat e administrimit në përputhje me parashikimet e Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar dhe Statutit të shoqërisë.
- 8.3. Administratori është i autorizuar të veprojë në emër të *Shoqërisë* në formim e sipër deri në regjistrimin e saj pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit si dhe ka të drejtë t’i delegojë kompetencat e tij personave të tjerë.
- 8.4. Administratori do të qëndrojë në detyrë për 5 (pesë) vjet dhe gëzon të drejtën e riemërimit në këtë detyrë pas përfundimit të mandatit të tij.

NENI 9 DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

- 9.1. Çështjet që nuk trajtohen në këtë Akt Themelimi, rregullohen në Statutin e *Shoqërisë* si dhe në legjislacionin shqiptar në fuqi.
- 9.2. Ky Akt Themelimi është hartuar në Tiranë, Shqipëri në 3 (tre) kopje origjinale në gjuhën shqipe, duke patur të gjitha të njëjtën fuqi ligjore.

O R T A K Ë T


Znj. Andrea Berner


Z. Albert Kola